



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:117961

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06330461

P.nr.588/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili në çështjen penale kundër të pandehurit B.K., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 320 paragrafi 1 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.289/18 e datës 02.08.2018, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 07.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë me numër PP.II.nr.289/18 e datës 02.08.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit:

B... K... nga i ati R..., e ëma S... e gjinisë F..., i lindur me datë ... në fshatin Q..., Komuna e Zubin Potokut, me adresë të vendbanimit Rr. "...", Mitrovicë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale që ka arritur me datë 08.08.2024.
- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Pala e dëmtuar, KEDS-Mitrovicë nga Mitrovica, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.289/18 me datë 02.08.2018 kundër të pandehurit B.K. për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjyqtari e ka pranuar këtë lëndë më datë:02.09.2024 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas aktakuzës, i pandehuri është akuzuar se ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së për të cilën veprën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tri (3) vjet.

Neni 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim. Ndërkaq, sipas nenit 107 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 8 përcaktohet se ndjekja penale ndalohe në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lart cekura konstaton se nga data 08.08.2017 kur dyshohet se i pandehuri B.K. ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-së për këtë veprën penale kanë kaluar me tepër se tetë (8) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur më 08.08.2022, ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë veprën për të cilën është akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Aktvendimi mbi parashkrimin absolut është bazuar në kuptim të nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenit 107 paragrafi 8 të KPRK-së, si dhe neni 357 të KPP-së, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Për sa i përket kërkesës pasurore juridike, Gjykata ka vendosur që të dëmtuarën ta udhëzoj që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil, në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPP-së, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktvendimi

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenit 107 paragrafi 1 dhe 8 të KPRK-së, e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.588/2018, datë 07.10.2024

Gjyqtarja
Dardane Ismaili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimit të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.